

**Prof. Asoc. Dr. Ardit Bido**

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

## **JO MUZE, MUZE ARKIVOR**

### **Abstrakt:**

Në këtë artikull do të përshkruhet një nga punët më ambicioze të DPA vitet e fundit. Pas suksesit me procesin e digjitalizimit dhe shërbimeve on-line, projekti pasardhës është ndërtimi i muzeut arkivor, një tipologji e veçantë muzeale, që tenton njohjen e publikut të gjerë me pasurinë arkivore.

**Fjalë kyçe:** *muzeologji, muze arkivor, muze tipologjik, promovim, trashëgimi kulturore.*

### **Abstract:**

In this paper we will describe one of the most ambitious projects of the General Directorate of the Archives in the last years. After the successful accomplishment of the process of digitalization and on-line service, the coming project is the construction of the archival museum, a specific museum typology that aims to inform the vast public about the archival treasures.

**Keywords:** *museology, archival museum, typological museum, promotion, cultural heritage.*

Muzeu arkivor është një muze tipologjik, që i përshtatet karakterit të institucionit, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe çdo arkiv në botë nuk ka në përmbajtjen e vetë objekte, por dokumente. Dokumentet që ruan dhe administron DPA-ja janë pjesa dërrmuese e historisë së kombeve të njëri-tjetrit. Ndër to, nuk janë vetëm dokumentacioni i historisë shqiptare, por i thuajse të gjitha kombeve fqinje, që në historinë bashkëkohore janë gjendur dhe janë ruajtur brenda territorit shqiptar. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka të gjithë potencialin për të pasur një Muze Arkivor. Por edhe pse e pasur me fonde arkivore, DPA ndeshi në vështirësi tek gjetja e infrastrukturës ku do të ngrihej Muzeu. DPA-ja ka një ndërtesë të vogël në

Tiranë në pjesën e pasme të godinës kryesore e cila u përzgjedh për ngritjen e Muzeut Arkivor.

Me krijimin e kushteve të përgjithshme, u krijuan mundësitë reale të ndërtimit me rrëzimin e mureve rrethuese, ndërhyrje të thella në infrastrukturë, etj. Gjithsesi problemi kryesor ka qenë ndërtesa, ajo ishte mjaft e vogël (3.5 m lartësi) dhe në formë kubike, e përbërë nga tre seksione, çdo 250 m<sup>2</sup>. Pra, përmasa dhe hapësira e saj nuk mjaftonin për një muze. Ndërtesa kërkonte një rikualifikim në kuptimin e vërtetë të fjalës, pasi ishte krejtësisht e papërshtatshme për qëllimin që i caktuam. Vështirësia e parë ishte gjetja e zgjidhjes më të mirë për ta kthyer një ndërtesë në formë kubike në një mjedis ekspozimi dhe duhej të kthehej nga vendruajtje arkivore, në një sallë solide për njerëzit, që dëshirojnë të shikojnë dokumentet.

U vlerësua nga stafi i DPA se duhej një mjedis / bibliotekë me materiale teknologjike, audio-vizuale dhe një sallë konferencash. Është qëllim në këtë projekt të krijohet një hapësirë ku çdo studiues të kalojë të gjitha ditët e tij atje, por gjithashtu edhe çdo qytetar apo vizitor që nuk është studiues, të gjejë një rrugë për në arkivat tona. Muzeu Arkivor do të ketë qasje për të interesuarit nga një derë të dytë dhe e pavarur nga mjediset e tjera të DPA-së. (Gjysma e institucionit ka akses të kontrolluar, gjysma e mbetur është e hapur për vizitorët).

Përzgjedhja e dokumentacionit për ekspozim ka qenë çështje jo vetëm e stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, por edhe ndërinstitucional. Propozimi i parë ishte që të mos kishim një ekspozitë të përhershme dhe të kishim vetëm ekspozita jo të përhershme, që ende është ideja kryesore. Ekspozita e përhershme do të ketë një çështje, që është “arkivat përmbajnë gjithçka”. Mjedisi tjetër i Muzeut është pjesa e tretë e cila do të jetë një sallë konferencash me një hyrje të ndryshme, një hyrje për ngjarje / mësim / prezantime librash, e kështu me radhë, me kapacitet 150 vende.

Ideja pas kësaj është që në këtë mjedis mund të kemi konferenca, mund të organizojmë ngjarje në hapësirën që në fillim duket jashtë kësaj zone ekspozite. Në të njëjtën kohë, salla e konferencave lidhet me hapësirën e ekspozitës për rastet kur mbahet një kongres dhe ka nevojë për një ekspozitë jo të përhershme në bazë të tij. Gjithashtu, është parashikuar një mjedis kreativ për studiuesit, por po bëjmë edhe një sallë studimi në hapësirë të hapur. Është një koncept virtual i studimit, diskutimit dhe shkëmbimit të ideve në një mjedis të hapur, përmes një platforme elektronike normale, e vendosur në sallën tonë të studimit.

Mjedisi i ekspozitës kryesore të përhershme përmban tre pjesë kryesore. E para është në dysheme dhe fabula pas saj janë “themelet” ku ne ecim.

Shprehjet e personaliteteve të rëndësishme shqiptare gjatë historisë janë të shkruara në xhamin e dyshemesë së mjedisit që vizitojmë. Në mes ndodhet pjesa me libra nga koleksionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Këta do të jenë objektet tona me rëndësi historike, “themelet” mbi të cilat ne ecim. Në mes do të jenë vendosur ekspozitorë elektronikë dhe tradicionalë. Secili do të përfaqësojë një komponent të arkivave. Tri prej tyre me dy anë, që do të thotë se janë gjashtë pjesë dhe secila prej tyre do të përfaqësojë një komponent të historisë sonë kombëtare. Nëpërmjet arkivave do të tregohet për lashtësinë. Nëpërmjet koleksioneve të bibliotekës, do të tregohet për ngjarje në gjashtë shekuj histori. Përmes koleksionit të hartave në DPA-së, do të prezantohet historia kombëtare deri në shekullin e 16-të.

Koleksioni i rrallë i kodikëve dhe i dorëshkrimeve osmane, arabe dhe perse në DPA do të tregojë historinë shqiptare deri në shekullin e 20-të. Në fundi do të jenë fotot e Koleksionit të Fototekës që do të tregojnë historinë kombëtare deri në vitin 1945. Përmes materialeve audio- vizuale të Koleksionit të Fonotekës do të prezantohet pjesa e historisë bashkëkohore. Ekspozitorët në krah do të përmbajnë idenë e historisë sonë shoqërore njerëzore që do të thotë lindje-vdekje-martese-dashuri-urrejtje-dhunë dhe çdo ngjarje që lidhet me jetën njerëzore dhe me njerëzimin, sepse arkivat përmbajnë gjithçka. Ato përmbajnë historinë dhe jetën shoqërore. Në pjesën e sipërme të sallës do të jenë vendosur tetë ekrane / monitorë, ndarë në katër grupe me nga dy syresh. Pjesa e sipërme do të dalë për të ekspozuar proceset e restaurimit. Pjesa e poshtme do të jetë një pjesë ndërvepruese që vizitori duhet të veprojë për të parë dokumentin.

Muzeu Arkivor është sot një nga projektet më ambicioze dhe me të njëjtën energji që po zbatohet, po ashtu dhe shpresojmë që kjo sipërmarrje të ngjallë interes tek studiuesit dhe publiku i gjerë.